



**KONTRATË KALIMI KUOTASH**  
**ME SHITJE**

Sot, më datë 29/06/2018 (dymijë e tetemdhjete) para meje Noteres Edlira TELHARAJ, në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil, ligjit "Për Noterinë", si dhe ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.9901, Date 14.4.2008, "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

*personat e mëposhtëm, kërkuan përpilimin e kësaj kontrate shitje kuotash, si më poshtë:*

- **Barbara PORTELLI**, shtetase italjane, atesia Giampiero, lindur ne Novara (NO) me 08/12/1983 dhe banuese ne Trecate me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me dokumentin e identitetit nr. AY6462134.
- **Hadi Abdul Ghafour**, shtetas italgjan, atesia Ahmad, lindur ne Mina – Liban me 29/05/1981 dhe banues ne Tracate, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me dokumentin e identitetit nr. AY6462489

*(i cili këtu e në vijim do të quhet **Shitësit**)*

- **Luana BARBUZZI**, atesia Michele, lindur me 10.11.1984 ne Grottaglie (TA), banues ne, Grottaglie, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me dokumentin e identitetit nr. AS7183958.

*(te cilet këtu e në vijim do të quhen **Blerësi**)*

**OBJEKTI:**

Kalimi i së drejtës së pronësisë, mbi **33,33 %** te kapitalit të shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k, zotëruar tërësisht nga Shitësit, te Blerësi dhe zhveshja e palës Shitëse nga të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga qenia ortak mbi **33,33 %** te kapitalit mbi kete shoqëri.

**TË DHËNA PARAPRAKE:**

- a. Shoqëria "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k, është regjistruar si person juridik prane QKB-se, me NIPT L81626019S, me kapital themeltar me vlerë 10.000 leke (dhjete mije lekë) dhe ka status aktiv.
- b. 100 % te kapitalit te Shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k zoterohen nga Shitesit, perkatesisht ne perqindje palet zoterojne: Barbara PORTELLI zoteron 50% te kapitalit te shoqërisë dhe Hadi Abdul Ghafour zoteron 50% te kapitalit te shoqërisë.
- c. Me vendimin e dates 29.06.2018 Asambleja e Ortakeve ka miratuar shitjen e pjeseve te kapitalit te ortakeve shites te bleresi.

Në mbështetje të nenit 73 të ligjit nr.9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.9901, Date 14.4.2008,

"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", nenit 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" i ndryshuar dhe neneve përkatëse të Statutit të Shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k, Shitësit dhe Blerësi bien dakort midis tyre për shitjen dhe blerjen e kuotave të Shitësve, me kushtet si vijon duke hequr dore nga e drejta e parablerjes per pjesen qe i transferohet Bleresit jo ortak:

## Neni 1 Objekti


- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është realizimi i shitjes nga Shitësit te Blerësi, ne total i **33,33 %** (tridhjetë e tre/33 përqind) te kapitalit të shoqërisë, dhe zhveshja e shitesve nga te drejttat qe burojne mbi keto pjese perkatesisht:
- 1.1.1 **Shitesi Hadi Abdul Ghafour** nga momenti i nenshkrimit te ketij akti, zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qënia ortak në shoqëri mbi pjesen **16.67 %** te kapitalit te shoqerise;
- 1.1.2 **Shitesi Barbara Portelli** nga momenti i nenshkrimit te ketij akti, zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qënia ortak në shoqëri per pjesen **16.66 %** te kapitalit.
- 1.2 Pas kalimit te **33,33 %** te pjeseve te kapitalit te shoqerise "ASSISTENTINVALIGIA" shpk, ne favor te Bleresit, ne menyren e percaktuar ne kete akt, ortaket do te zoterojne perkatesisht keto pjese kapitali:
- 1.2.1 Ortaku **Hadi Abdul Ghafour** mbetet zoterues i **33,33 %** te pjeseve te kapitalit te shoqerise
- 1.2.2 Ortaku **Barbara PORTELLI** mbetet zoterues i **33,34 %** te pjeseve te kapitalit te shoqerise
- 1.2.3 Ortaku **Luana BARBUZZI** behet zoterues i **33,33 %** te pjeseve te kapitalit te shoqerise.

## Neni 2 Çmimi i shitjes

- 2.1 Palët kanë rënë dakort dhe kanë përcaktuar se çmimi total i shitjes se **33,33 %** të kapitalit të shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" Sh.p.k është **3.333 lekë** (tremije e treqinde e tridhjetë leke) duke u paguar nga Bleresi Luana BARBUZZI ne kete menyre:
- **1.666 leke** perfitohen nga shitesi Barbara PORTELLI dhe
  - **1.667 leke** nga shitesi Hadi Abdul Ghafour.
- 2.2 Palet pranojne dhe deklarojne se shuma permendur me siper është likujduar per llogari te Shitesve perkatesisht nga Bleresi jashte kesaj zyre noteriale dhe palet nuk kane asnje pretendim ne lidhje me te.

## Neni 3 Kalimi i pronësisë

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate realizohet kalimi i **33,33 %** te kapitalit te shoqerise nga pala Shitëse te pala Blerëse dhe Shitësit zhvishen nga te drejttat dhe detyrimet qe i buronin nga qenia pronar mbi keto pjese te kapitalit, detyrime e te drejta te lindura nga momenti i nenshkrimit te ketij akti.
- 3.1.1 Perkatesisht **Ortaku Barbara PORTELLI** zhvishet nga e drejta qe kishte mbi **16,66 %** te kapitalit te shoqerise duke ruajtur cdo te drejte mbi **33,34%** te kapitalit te kesaj shoqerise dhe
- 3.1.2 **Ortaku Hadi Abdul Ghafour** zhvishet nga e drejta qe kishte mbi **16,67 %** te kapitalit te shoqerise duke ruajtur cdo te drejte mbi **33,33%**



- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala Blerëse, bëhet zotëruese e **33,33 %** të kapitalit të shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k, duke marrë persiper të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga qenia pronar mbi pjeset perkatese të kapitalit të shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k, të lindura nga momenti i nënshkrimit të këtij kalimi pronarie
- 3.3 Pala Blerëse deklaron se është dakort me kalimin e **33,33 %** të kapitalit të shoqërisë në favor të tyre duke mbartur të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga qenia ortak në shoqërinë "ASSISTENTINVALIGIA" Sh.p.k.

#### Neni 4

##### Deklarime të palëve

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se, 33,33 % të kapitalit të shoqërisë, "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k, që i transferohen Blerësit, janë të lira nga çdo barrë dhe menjëherë lirisht të transferueshme të Blerësi, dhe mbi to nuk ka asnjë të drejtë juridike apo monetare të të tretëve.
- 4.2 Pala Blerëse deklaron se e njëj gjendjen e shoqërisë si me sipër, e pranon transferimin e 33,33 % të kapitalit të shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k, në favor të vet duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që do të burojnë nga këto kuota, të lindura nga momenti i nënshkrimit të kontrates.

#### Neni 5

##### Data efektive e kontratës

- 5.1 Kjo kontratë është efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, që nga data e nënshkrimit të saj.

#### Neni 6

##### Zgjidhja e Kontratës

- 6.1 Asnjë nga palët nuk mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë.

#### Neni 7

##### Hartimi i Kontratës, aktet bashkëlidhur


- 7.1 Kontrata u hartua në 5 (pesë) kopje të barazvlefshme, në gjuhën shqipe dhe italyane me vlerë të njëjtë ligjore.
- 7.2 Kjo Kontratë zëvendëson çfarëdolloj marrëveshje, kontrate ose çfarëdolloj dokumenti tjetër dhe është e vetmja Kontrate detyruese për Palët në lidhje me objektin e shitjes.
- 7.3 Kontratës i bashkëlidhen aktet e mëposhtme:
- Ekstrakti i shoqërisë "ASSISTENTINVALIGIA" sh.p.k,
  - Kopje të dokumenteve të identifikimit të palëve.
  - RBS

#### Neni 8

##### Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 8.1 Kjo Kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, nëse vetë palët me ndihmë juridike vazhdojnë të mos t'i kuptojnë e zbatojnë, si dhe në rast se vetë palët nuk gjejnë mirëkuptim, mosmarrëveshjet bëhen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës Kompetente.

 Blerësi  
Gledi AG. sh.p.k. sh.p.k. sh.p.k.

 Shitësi

Neni 9

**Interpretimi i Kontratës në tërësi**

- 9.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

*Kontrata e shitjes se kuotave, iu lexua palëve me zë të lartë e të qartë nga unë noteri, ne gjuhën italiane. U lexua prej vetë atyre, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plot e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj regullisht, në përputhje me ligjin.*

**PALËT**

**SHITËSIT**

BARBARA PORTERI

Barbara Porteri

**BLERËSI**

LUANA BAFBUZZI

Luana BafbuZZi

HADI ABDUL GHAFOUR  
Hadi AG



**NOTER**

**Edlira TELHARAJ**

Edlira Telhara



Edlira Telhara